



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial
Council

KPK/Nr. 1576/2022
Datë: 23 dhjetor 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafin 1 nën paragrafin 1.25 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësine Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullore 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve në takimin e mbajtur më datë 23 dhjetor 2022, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Paneli Hetimor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.15/2022 në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në këtë përbërje:
 1. Shukri Jashari, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj – Kryesues;
 2. Drita Hajdari, Prokurore në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës – Anëtare
 3. Sanije Gashi Seferi, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, Anëtare
- II. Komisioni do të ketë anëtarët rezervë në këtë përbërje:
 1. Petrit Kryeziu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren
 2. Shahadin Destani, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren
- III. Obligohen anëtarët e Komisionit nga pika I dhe II e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet :

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së;